Република Северна Македонија-Republika e Maqedonisë së Veriut
Средно Општинско Училиште Гимназија-Shkolla e mesme Komunale Gjimnazi
"Кирил Пејчиновиќ" Ц.О. "Kiril Pejçinoviq" P
Бр./Nr. 0901-2274
09. IV. 2026 год./viti
Тетово - Tetovë

SHMK-GJIMNAZI "KIRIL PEJÇINOVIQ" TETOVË

Në bazë të njoftimit të të publikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës-Shkup, Komisioni Kryesor i Shkollës së Mesme "Kiril Pejçinoviq"-Tetovë shpall si në vijim:

KONKURS
PËR RREGJISTRIM TË NXËNËSVE PËR VITIN E PARË SHKOLLOR 2026/2027

- Në vitin e parë do të regjistrohen **476** nxënës ne **14** paralele dhe ato:
- **MËSIMI NË GJUHËN MAQEDONE (68 NXËNËS TË SHPËRNDARË NË 2 PARALELE)**
- **ARSIMI GJIMNAZIAL:**
  - -Shoqëroro-humanitar..... **34** nxënës në **1** paralele **60** pikë minimum
  - -Matematiko-natyrorë..... **34** nxënës në **1** paralele **60** pikë minimum

- **MËSIMI NË GJUHËN SHQIPE 408 NXËNËS TË SHPËRNDARË NË 12 PARALELE**
- **ARSIMI GJIMNAZIAL**:
  - - Shoqëroro-humanitar... .....**204** nxënës ne **6** paralele **60** pikë minimum
  - -Matematiko-natyrorë..... **170** nxënës ne **5** paralele **60** pikë minimum
  - - Gjuhësorë-artistik..... **34** nxënës në **1** paralele **60** pikë minimum

I.KUSHTET PËR REGJISTRIMIN DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NXËNËSVE:
Regjistrimi i nxënësve në **SHMK Gjimnazi "Kiril Pejçinoviq"-Tetovë në vitin shkollor 2026/2027** do të bëhet në kushte dhe në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për Arsimin e Mesëm, Ligjin për Arsimin Profesional për Konkursin e dhënë.
Kushtet për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë janë:
-të ketë mbaruar arsimimin fillor
-të mos jenë më të vjetër se **17** vjet,ndërsa nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të mos jetë më i vjetër se **25 vjeç.**
-të përcaktohen për plan dhe programe te arsimimit gjimnazial;
-t'i plotësojne kriteret konform Konkursit
Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve arsimi i mesëm gjimnaz janë:
-suksesi mesatar i nxënësit nga klasa **VI-IX**;
-suksesi mesatar i arritur nga katër/4 lëndë : gjuhë amtare,gjuhë e huaj, dhe dy lëndë të rëndësishme për sektorin,
-diploma nga vendet e fituara I-rë;II-të dhe III-të në garat ndërkombëtare , si dhe marja e vendit të parë në garat shtetërore të organizuar nga shoqata të akredituara të mësimdhënësve për realizimin e garave në arsimin fillorë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- vlera mesatare e pikëve të marra për sjelljen nga klasa **VI** deri në **IX.**

Nxënësit e përkatësisë etnike romë mund të rregjistrohen nëse kanë deri në **10%** më pak nga numri i pikëve të parapara me këtë shpallje,për planet dhe programet mësimore përkatëse dhe nëse plotësojnë kriteret shtesë për testin e njohurive dhe aftësive në shkollën përkatëse.

Në shkollat ku konkurojnë numër më i madhë i nxënësve që i plotësojnë kushtet nga numri i planifikuar i paraparë në këtë konkurs ,për ata që përmbushin kushtet e parashikuara,organizohet test kualifikues nga materiali mësimorë nga klasa e tetë-nëntë në lëndët mësimore vijuese edhe atë:
-për arsimin e mesëm gjimnazial-gjuhë amtare dhe matematikë,

Për suksesin e mesëm nga klasa VI deri në IX nxënësi mund të marrë maksimumi 50 pikë (sukses i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, e shtatë, e tetë dhe e nëntë mblidhet pastaj pjesëtohet me katër dhe i njëjti numër shumëzohet me koeficienti 10).
Për suksesin mesatar të arritur nga katër lëndët e propozuara (dy lëndë i detyrueshëm për të gjitha llojet e arsimit dhe dy lëndë që kanë lidhje me profesionin), nxënësi mund merr një maksimum prej 20 pikësh (5 pikë për çdo lëndë).
Për vendin e fituar në Gara ndërkombëtare dhe shtetërore nxënësi mund të fitojë:
-Për vendin e parë të fituar ose medaljen e artë në gara ndërkombëtare5 pikë,vendi i dytë ose medalja e argjentë 4 pikë dhe vendi i tretë ose medalja e bronztë 3 pikë.
-Për vendin e fituar nga garat e akredituara shtetërore: për vendin I - 3 pikë, për vendin e II - 2 pikë dhe për vendin III - 1 pikë.
Për vlerën mesatare të pikëve për sjellje nga klasa VI deri në IX nxënësi mund të marrë maksimumi 5 pikë. (Sjellja shembullore vlerësohet me 5 pikë, sjellja e mirë vlerësohet me 3 pikë dhe sjellja e pakënaqshme vlerësohet me 0 pikë. Vlera mesatare është shuma e pikave të sjelljes nga klasa e gjashtë, e shtatë, e tetë dhe e nëntë e ndarë me 4).
Numri minimal i përcaktuar i pikëve për aplikimin e parë është pjesë përbërëse e këtij Konkursi.

ARSIMI I MESËM GJIMNAZ-lëndë të detyrueshme :gjuhë amtare dhe matematikë.

II.DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Pas rregjistrimit të suksesshëm elektronik, nxënësit që janë në listë dorëzojnë dokumentacionin në vazhdim:

- fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjen nxënësit mund të gjenerojnë duke printuar fletparaqitjen elektronike përmes sistemit të shërbimeve elektronike);
- dëftesa origjinale nga klasa VI deri në klasën IX;
- diploma, (nëse ka) nga vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amtare, gjuhë të huaj, shkencta natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe lëndët mësimore që janë të rëndësishme për profesionin, drejtimin, përkatësisht në fushën zgjedhore;
- çertifikata nga libri amë i lindjes (pavarësisht nga data e lëshimit).

VËREJTJE:Dokumentet mos të dërgohen me postë.

III. AFATET E KONKURSIT

Rregjistrimi i nxëxnësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik ,përmes linkut në portalin për shërbime elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës https://e-uslugi.mon.gov.mk me paraqitje speciale për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të **Schools.mk.**

AFATI I QERSHORIT PËR REGJISTRIM:

Paraqitja e parë elektronike e nxënësve do të bëhet **prej orës 00.00 të dates 12.06.deri ora 23:59 të dates 15.06.2026.**
Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkollë bëhet më datën **16 qershor2026 nga ora 08.00 deri në orën 19.00 dhe më 17 qershor 2026 nga ora 08.00 deri në orën 15.00**.

-Renditja përfundimtare e secilës shkollë me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen më **18 qershor 2026, më së voni deri në ora 12:00** në tabelën e shpalljeve të shkollës apo faqen zyrtare të shkollës.

Testi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm **më 22 qershor 2026**, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohet-ditën e njëjtë **më 22 qershor 2026** në tabelën e shpalljeve të shkollës apo web faqen e shkollës.

Paraqitja e dytë elektronike e nxënësve do të bëhet **më datë 23 qershor 2026 prej orës 00.00** deri në orën **23.59.**

Dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në shkolla bëhet në datën **24 qershor 2026 nga ora 08.00- 15.00**.
Renditja e listës përfundimtare me rezultatet e rregjistrimit dhe vendet e lira do të secila shkollë do ta publikojë më **25 qershor 2026** më së voni deri në ora **12.00** në vend publik në shkollë ose në web faqen zyrtare të shkollës.

Testi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm **më 29 qershor 2026,** ndërsa listat përfundimtare me rezultatet do të publikohenditën e njëjtë **më 29 qershor 2026,** në tabelën e shpalljeve të shkollave.

AFATI I GUSHTIT PËR REGJISTRIM:

Nxënësit të cilët dërgohen në riprovim korrigjues,provim vjetor,provime për përparim më të shpejtë,mund të rregjistrohen në shkollat ku ka vende të lira dhe i plotësojnë kushtet e parapara nga konkursi,pas afatit të qershorit me dy paraqitje.
-Paraqitja e nxënësve do të bëhet me date **20 gusht 2026 nga ora 00:00 deri ne ora 15:00** në mënyrë elektronike.
-Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla bëhet me **datë 21 gusht 2026 prej orës 08:00 deri** në orën **14:00**.
-Lista përfundimtare me rezultatet e regjistrimit ,secila shkollë do ta publikojë më **21 gusht 2026** të **njëjtën ditë,** më së voni deri ora **19:00.**
-Pas publikimt të listës ranguese përfundimtare me rezultatet e regjistrimit,nxënësit të cilët nuk janë rregjistruar në shkollë ,janë obligjuar të tërheqin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në shkollë brenda **24 orëve,**ndërsa shkollat kanë detyrim tua kthejnë të gjithë dokumentacionin nxënësve brenda **24 orëve.**

Përpiloi dhe hartoi: Sami Vehapi –Këshilltarë për çështje Normativo Juridike-Sekretar

Tetovë
09.04.2026

Jeton Kamberi

Digitally signed by Jeton Kamberi
Date: 2026.04.09 09:40:37 +02'00'

Nga Komisioni Shkollorë për Rregjistrim të nxënësve në vitin 2026/2027 shkollor
Drejtor/Kryetar
Jeton Kamberi